

VENDIM
Nr. 741, datë 5.9.2013

PËR SHKËMBIMIN E NJË PRONE TRUALL ME SIPËRFAQE 500 M², BRENDA ZONËS KADASTRALE 8518, PLAZH DURRËS DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1058, DATË 16.7.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI KËSHILLIT TË MINISTRAVE, PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERTARE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4, 5, 6, 10, 11, 13 e 14 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, dhe të nenit 757 të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkëmbimin e pronës shtetërore, truall, me sipërfaqe 500 (pesëqind) m², regjistruar me numra pasurie 47/51 dhe 47/63, në zonën kadastrale 8518, në përgjegjësi administrimi të Këshillit të Ministrave dhe në përdorim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, me pasurinë truall, pronë private, me sipërfaqe 500 (pesëqind) m², regjistruar me numër pasurie 51/21, në zonën kadastrale 8518, në adresën lagjja 13, plazh Durrës, sipas planvendosjeve dhe kartelave që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shkëmbimi i këtyre dy pronave të kryhet pa shpërblim apo kompensim mbi vlerën e tyre.

3. Shkëmbimi të realizohet nëpërmjet një kontrate shkëmbimi, e cila të nënshkruhet nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare me pronarët e pronës që shkëmbehet.

4. Pas shkëmbimit, pasuria truall, me sipërfaqe 500 (pesëqind) m², regjistruar me numër pasurie 51/21, në zonën kadastrale 8518, në adresën lagjja 13, plazh Durrës, të përdoret nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare.

5. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme, bashkëlidhur vendimit nr. 1058 të Këshillit të Ministrave, hiqet pjesa e pronës, me numra pasurie 47/51 dhe 47/63 dhe shtohet prona me numër pasurie 51/21, të cilat përmenden në pikën 1 të këtij vendimi.

6. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha